



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 31/10/2025

Proces-verbal

Bazuar në ligjin nr 139/2015, neni 3, pika “dh”, në datat 23, 24 dhe 25 Shtator 2025 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvilluan takime me banorët e Rajonit 1, 2 dhe 3 të qytetit të Korçës.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin Z.Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletjon Kita Zv.Kryetar Bashkia Korçë, Mareglen Hoxhalli Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndriçim Hoxha Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, Soniel Prifti Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, Ana Verushi Kryetare e Këshillit Bashkiak Korçë si dhe përfaqësues të Këshillit Bashkiak.

Fjalën e mori i pari z.Sotiraq Filo, i cili përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, si një mekanizëm që garanton përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Gjithashtu, listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara dhe në proces për t'u realizuar në qytetin e Korçës. Mes tyre përmendi Ndërtimin e “Polit të Dijes” një hapësirë e cila do të ketë një infrastrukturë moderne të bollshme për auditorë, laboratorë, bibliotekë dhe do ta çojë arsimin universitar të Korçës në një nivel të ri duke e bërë më konkurrues falë programeve të reja të ndërkombëtarizimit dhe ngritjes së qendrave të kërkimit shkencor, rikthimi i liceut francez me mbështetjen e dy qeverive, rikonstruksioni i godinës së ish bibliotekës së fëmijëve e cila nuk do të shërbeje vetëm si bibliotekë tradicionale por do të jetë në funksion të një programi që synon më shumë mundësi punësimi për të rinjtë duke i afuar sa më shumë me

teknologjinë. Gjithashtu ka përfunduar projekti i ndërtimit të Qendrës Rinore, me fokus si një qendër për të kaluar kohën e lirë dhe për të kryer aktivitete të ndryshme jashtëshkollore, rikonstrukcioni i pallatit të sportit “Tamara Nikolla”, projekti i përmirësimit të kushteve të banimit për banesat e familjeve në gjendje të vështirë ekonomike. Gjithashtu, përmendi se ka filluar ndërhyrja për lirimin e hapësirave publike dhe se faza tjetër do të jete ndërhyrjet rigjeneruese për t’i kthyer këto hapësira në sipërfaqe të gjelbra, për t’i sistemuar dhe në hapësirat ku ka më shumë sipërfaqe të vendosen stola. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioritetëve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti përceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2026. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

1. Përmirësimi i kushteve të banimit në banesat ekzistuese
2. Asfaltimi i disa rrugëve në qytet
3. Shtimi i këndeve sportive, stolave, mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra
4. Termoizolimi i pallateve
5. Vendosja e kufizuesve të shpejtësisë në disa prej rrugëve problematike

XXX: Banor, Lagjja 10: Ju falenderojmë për punën e bërë për lulishtet dhe për stolat që keni vendosur. Në karburanti “Cenolli” është një stacion urbane. Atje mungojnë vijëzimet e bardha. Është e nevojshme të bëhen sepse kanë ndodhur shumë aksidente, e nëse ka mundësi të vihen edhe “policë të shtrirë”. Ju falminderit!

XXX: Banor, Lagjja 11: Tek Rruga “Petraq Shomo janë disa godina shumë të rrezikshme për banorët sepse janë të amortizuara, qoftë edhe godina private duhet të merren masat. Gjithashtu kendet e lojërave të fëmijëve janë të gjitha të amortizuara, duke përbërë rrezik për fëmijët. Këto kënde lojërash duhen rinovuar të gjitha. Shkallët tek varrezat e dëshmorëve, vit pas viti amortizohen. Rruga që shkon nga kisha “Shën Thanasi” deri rrëzë malit të Moravës ka nevojë për vijëzim, për stola, si edhe për ndriçim sepse kjo rrugë është kthyer në një shëtitore. Dhe një

problem tjetër janë kabujt e kolonave në rrugicat e qytetit. Janë marrë masa vetëm prapa bashkisë a do të vazhdojë edhe në vendet e tjera?

XXX: Banor, Lagjja 4: A është menduar për ndonjë hapësirë sportive (kënde) për fëmijët tæk L.4, tek ish fusha e druve? Faleminderit!

XXX: Banor, Lagjja 2: Pallati tek Creperia është i vetmi pallat pa termoizolim. A është në plan për t’u bërë?

XXX: Banor, Lagjja 14: Dëgjova me vëmendje projektet që ka në plan bashkia të zhvillojë. Kam mendimin që duhet punuar më shumë për rritjen e nivelit të mësimdhënies dhe të cilësisë sepse godinat bëhen. Në lidhje me aksionin për lirim e hapësirave publike, duhet punuar me njerëz që ti kuptojnë dhe më pas t’i zbatojnë. Ato pallate që kishin gjelbërim rreth e rrotull (ligustra) ishin më mirë ashtu sesa tani që u shkatërruan. Duhet bërë aksion për pastrimin, sistemimin dhe rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, projekt buxheti duhet shpërndarë më mirë nëpër lagjet e qytetit. Pallatet në lagjet 13 dhe 14 duhen bërë me termoizolim, ka shumë banorë të sëmurë, të moshuar të vetmuar që kanë probleme me lagështirën.

XXX: Banor, Lagjja 13: Përshëndetje. Doja të mbështes orientimin ndaj arsimit sepse është e ardhmja e fëmijëve, por dua të flas për disa gjëra konkrete. Midis lagjes 13 dhe lagjes 5 është bërë problem pjesa e rrugës “10 Korriku”, për 3 kryqëzime që janë burim aksidenti. Është një aks i populluar dhe kanë ndodhur shumë aksidente, prandaj kërkojmë të vendosen “polica të shtrirë” për të kufizuar shpejtësinë. Dhe problemi tjetër ka të bëjë me vazhdimin e projektit të termoizolimit të banesave sepse të gjithë e dimë që Korça është një qytet shumë i ftohtë.

XXX: Banor, Lagjja 4: Jam banor në lagjen 4. Mendoj që duhen më shumë qendra për të moshuarit për të kaluar kohën dhe për të luajtur me domino. Gjithashtu ka disa rrugë të lagjes që duhet të asfaltohen sepse janë të pa shtruara.

XXX: Banor, Lagjja 5: Në Rruga ”Rexhep Telhaj”, është problem rreth 70m² për të shtruar midis dy pallateve.

XXX: Banor, Lagjja 17: Jam banor i lagjes nr 17, rruga “Desaretet”. Një shqetësim që ngre është ai i një trotuari për kalimtarët. Kjo është një rrugë kryesore dhe kalojnë makinat me shpejtësi.

Gjithashtu, shqetësim është edhe kanali anës rrugës “Jani Riza”. Do të mbyllet ky kanal? Edhe disa rrugë janë të paasfaltuara.

XXX: Banor, Lagjia 7: Kemi një shqetësim shumë të madh për rrugën e pashtuar prapa ish maternitetit ne lagjen 7. Plus në këtë vend Ndërmarrja e Shërbimeve Publike grumbullon inertet gjë e cila na sjell shqetësime sepse bëhet shumë zhurmë. Një familje që jeton në këtë zonë ka marrë një pjesë të rrugës dhe e ka bërë oborr, ne kemi problem se nëse bie një zjarr nuk hyn as zjarrëfiksja. Duhet një sistemim, ndërhyrje në ndriçimin publik dhe kanalizimet.

XXX: Banor, Lagjia 9: Tek lulishtja “Shën Maria” kemi problem me qentë endacakë. Merrni masa se po na sulmojnë përditë.

XXX: Banor, Lagjia 17: Jam banore e lagjes 17, pallati 14, Rr.”Nevruz Nure” a ka ndonjë plan për investim për çatitë e pallatit tonë?

XXX: Banor, Lagjia 8: Lulishtja është shumë e bukur, por ska ndriçim, stolat janë të dëmtura. Edhe trotualet tek rruga janë shumë të dëmtuara. Kërkoj të ndrohen edhe koshat e mbeturinave janë të vjetër duhet të ndërrohen.

XXX: Banor, Lagjia 4: A ka plan për pjesën e mbetur të lagjes së re, tek ish fusha e druve? Faleminderit!

Rajoni 1



Rajoni 2



Rajoni 3



Përgjegjëse

Larisa Katundi